VENDIM
Nr. 72, datë 6.12.2017

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PLANET E RIMËKËMBJES SË BANKAVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të nenit 7, pika 7, nenit 8, pika 9 dhe nenit 11, pika 6 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për planet e rimëkëmbjes së bankave", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të rregullores së miratuar me këtë vendim, shfuqizohet udhëzimi "Mbi Planet e Rimëkëmbjes", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 26.02.2014.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Gent Sejko

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave mbikëqyrëse për planet e rimëkëmbjes së bankave dhe të grupeve bankare, lidhur me:

a) përmbajtjen e planeve të rimëkëmbjes dhe të planeve të thjeshtuara të rimëkëmbjes, mënyrën dhe afatin për paraqitjen dhe përditësimin e tyre;

b) kuadrin minimal të treguesve cilësorë dhe sasiorë, që përfshihen në planet e rimëkëmbjes; si dhe

c) kriteret minimale mbi të cilat kryhet vlerësimi i planeve të rimëkëmbjes nga Banka e Shqipërisë.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3
Baza juridike

1. Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;

b) nenit 7, pika 7, nenit 8, pika 9 dhe nenit 11, pika 6 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë" (më poshtë ligji "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme").

Neni 4

Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4, të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe në nenin 4 dhe kreun II, të ligjit "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme".

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "masa të rimëkëmbjes" është tërësia e veprimeve (apo strategjive) të përfshira në planin e rimëkëmbjes, që duhet të ndërmerren nga banka, për të rivendosur pozicionin financiar, në rast të një përkeqësimi të konsiderueshëm të gjendjes financiare të bankës ose grupit bankar;

b) "ndryshim i rëndësishëm" është çdo ndryshim që mund të ndikojë në aftësinë e bankës ose të çdo subjekti të grupit bankar, për të zbatuar planin e rimëkëmbjes apo për të zbatuar një ose disa nga masat e rimëkëmbjes, të parashikuara në planin e rimëkëmbjes;

c) "pengesë e rëndësishme (materiale)" është çdo faktor që mund të ndikojë negativisht mbi zbatimin në kohë të masës së rimëkëmbjes, duke përfshirë në veçanti, rreziqet ligjore, operacionale, të biznesit, financiare dhe reputacionale;

d) "shërbime kritike" janë operacionet /veprimtaritë/shërbimet e kryera për një (shërbim i dedikuar) ose më shumë njësi biznesi ose subjekte (shërbime të përbashkëta) brenda grupit, të cilat janë të nevojshme për të siguruar një ose më shumë funksione kritike;

e) "subjekt i rëndësishëm i grupit ose degë e rëndësishme e bankës" është një subjekt (person juridik) ose degë, që plotëson të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

i) kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në të ardhurat e grupit ose bankës të përfshirë në planin e rimëkëmbjes, në financimin e tij/saj ose zotëron një pjesë të rëndësishme të aktiveve, pasiveve ose kapitalit;

ii) kryen veprimtari kryesore për grupin ose bankën;

iii) kryen në mënyrë të përqendruar, funksione bazë operacionale, të administrimit të rrezikut ose funksione administrative, për grupin ose bankën;

iv) mbart rreziqe kryesore, të cilat sipas skenarit të përkeqësimit të gjendjes financiare, mund të rrezikojnë qëndrueshmërinë e grupit bankar ose të bankës;

v) shitja ose likuidimi i të cilit/cilës mund të ekspozojë bankën ose grupin në tërësi ndaj rreziqeve të rëndësishme;

vi) është i rëndësishëm për stabilitetin financiar të vendit;

f) "Ngjarje sistemike" - nënkupton një ngjarje që rrezikon të ketë pasoja të rënda negative për sistemin financiar ose ekonominë reale;

g) "Ngjarje specifike (idiosyncratic)" - nënkupton një ngjarje që rrezikon të ketë pasoja të rënda negative vetëm për bankën ose grupin bankar;

h) "*Stress-tes*t i anasjelltë"- është *stress-test*-i i bankës, i cili bazohet në identifikimin e rezultatit të paracaktuar dhe më pas shqyrton/vlerëson skenarët dhe rrethanat që mund të shkaktojnë këtë rezultat;

i) "Banka me rëndësi sistemike"- janë bankat e licencuara dhe që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara si të tilla, sipas vendimmarrjes së Bankës së Shqipërisë, për qëllime të kësaj rregulloreje;

j) "Metoda e parametrave të përshkallëzuar" (*progressive metrics*) - është metoda e përcaktimit të disa niveleve për treguesit sasiorë, duke marrë në konsideratë edhe oreksin/tolerancën ndaj rrezikut, derisa të arrihet kufiri i treguesit për aktivizimin e planit të rimëkëmbjes.

Neni 5

Kërkesa të përgjithshme

1. Banka harton dhe përditëson planin e rimëkëmbjes, të paktën një herë në vit, duke marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme që nga paraqitja (rishikimi) e fundit e planit, në profilin e rrezikut të bankës, kushtet e tregut dhe çdo faktor tjetër që ndikon në masat e rimëkëmbjes të propozuara në plan.

2. Banka, gjatë përgatitjes së planit të rimëkëmbjes, nuk merr në konsideratë mundësinë e mbështetjes financiare publike të jashtëzakonshme.

3. Banka përcakton në planin e rimëkëmbjes, strukturat përgjegjëse, proceset e nevojshme, kushtet e vënies në zbatim të planit dhe procedurat që sigurojnë zbatimin në kohë të masave të rimëkëmbjes.

4. Banka përcakton strukturën/njësinë e administrimit të rrezikut, si njësinë përgjegjëse për koordinimin e procesit të hartimit të planit brenda bankës, monitorimin e treguesve, përgatitjen e skenarëve dhe kryerjen e *stress-test*-eve të planit të rimëkëmbjes. Kjo njësi është përgjegjëse edhe për raportimin në Këshillin Drejtues mbi procesin e hartimit, nevojën për përditësim dhe zbatimin e planit të rimëkëmbjes, mbi vlerat e treguesve të përzgjedhur dhe mbi rezultatet e *stress-test*-eve të planit të rimëkëmbjes.

5. Banka, në varësi të natyrës, madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë së saj, ndan rolin e personave përgjegjës për hartimin e planit të rimëkëmbjes, nga ai i personave që janë përgjegjës për kryerjen e *stress-test*-eve të planit të rimëkëmbjes.

6. Banka nuk mund të përfundojë me të tretët marrëveshje për të transferuar plotësisht procesin e hartimit të planit të rimëkëmbjes.

7. Banka identifikon në planin e rimëkëmbjes, një numër të mjaftueshëm masash rimëkëmbjeje të zbatueshme, me qëllim përballimin e ngjarjeve specifike dhe sistemike, për të siguruar rikthimin e saj në një gjendje të qëndrueshme.

8. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me autoritetet e huaja mbikëqyrëse dhe me bankat e huaja, që kanë hapur degën ose filialin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim koordinimin e masave të planit të rimëkëmbjes, në kuadër të planeve të grupit bankar, pjesë e të cilit është subjekti.

KREU II
PËRMBAJTJA E PLANIT TË RIMËKËMBJES

Neni 6
Struktura e planit të rimëkëmbjes

1. Plani i rimëkëmbjes i hartuar nga banka përmban minimalisht:

a) një përmbledhje ekzekutive të elementeve kryesore të planit të rimëkëmbjes;

b) informacion të detajuar mbi elementet e mëposhme:

i) drejtimin e bankës;

ii) treguesit e rimëkëmbjes;

iii) analizën strategjike;

iv) masat e rimëkëmbjes;

v) skenarët;

vi) planin e komunikimit dhe informimit;

vii) analizën e masave parapërgatitore.

Neni 7
Përmbledhja ekzekutive e planit të rimëkëmbjes

1. Banka harton përmbledhjen ekzekutive të planit, e cila paraqet në mënyrë të qartë informacionin mbi aftësinë e saj për t'u rimëkëmbur, në rastet e një situate të përkeqësuar, si dhe i mundëson Bankës së Shqipërisë vlerësimin e përgjithshëm të masave të rimëkëmbjes.

2. Përmbledhja ekzekutive e elementeve kryesore të planit të rimëkëmbjes përmban informacionin e mëposhtëm:

a) një përmbledhje të çdo ndryshimi të rëndësishëm në bankë, në grupin bankar apo në planin e rimëkëmbjes, që nga koha e paraqitjes së planit të fundit për shqyrtim në Bankën e Shqipërisë;

b) një përmbledhje të planit të rimëkëmbjes mbi drejtimin e bankës, duke përfshirë edhe një përmbledhje të komenteve dhe rekomandimeve të këshillit drejtues, të kontrollit të brendshëm dhe të komitetit të rrezikut (në rast se ekziston në strukturën e bankës një komitet i tillë), për këtë qëllim;

c) një përshkrim të treguesve të rimëkëmbjes;

d) një përmbledhje të analizës strategjike të planit të rimëkëmbjes, duke përfshirë edhe një përmbledhje të kapacitetit/aftësisë së përgjith-shme për t'u rimëkëmbur;

e) një përmbledhje të skenarëve;

f) një përmbledhje të planit të komunikimit dhe informimit;

g) një përmbledhje të masave parapërgatitore, të përcaktuara në planin e rimëkëmbjes.

Neni 8
Drejtimi i bankës

1. Banka, në seksionin e planit të rimëkëmbjes mbi drejtimin, përfshin një përshkrim të detajuar të elementeve të mëposhtme:

a) roli dhe funksionet e personave përgjegjës për përgatitjen, zbatimin dhe përditësimin e çdo seksioni të planit;

b) emri i personit përgjegjës për të ndjekur përditësimin e planit të rimëkëmbjes;

c) përshkrimi i procesit të përditësimit të planit të rimëkëmbjes, me qëllim që plani t'u përgjigjet ndryshimeve të rëndësishme që ndikojnë bankën ose grupin bankar;

d) mënyra e integrimit të planit në sistemin e administrimit të rrezikut të bankës ose të grupit bankar;

e) nëse banka është pjesë e një grupi bankar, një përshkrim i marrëveshjeve brenda grupit, me qëllim sigurimin e koordinimit dhe përputh-shmërisë (konsistencës) së masave të rimëkë-mbjes në nivel grupi;

f) procedurat që rregullojnë procesin e miratimit të planit të rimëkëmbjes, duke përfshirë edhe rishikimin e tij nga njësia e kontrollit të brendshëm dhe komiteti i rrezikut (në rast se ekziston në strukturën e bankës një komitet i tillë), si dhe vlerësimin dhe miratimin nga këshilli drejtues i bankës;

g) kushtet dhe procedurat e nevojshme për të siguruar zbatimin në kohë të masave të rimëkëmbjes, duke përfshirë minimalisht:

i) një përshkrim të procesit të brendshëm të përshkallëzimit dhe të vendimmarrjes, që zbatohet kur arrihen treguesit, për të vendosur se cila masë rimëkëmbjeje duhet të zbatohet, në përgjigje të përkeqësimit të gjendjes financiare, duke përfshirë të paktën:

- rolin, funksionet dhe përgjegjësitë e personave të përfshirë në këtë proces, si dhe, nëse në këtë proces është përfshirë edhe ndonjë komitet, rolin, funksionet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të komitetit;
- procedurat që duhet të ndiqen;
- afatin kohor për vendimin mbi zbatimin e masave të rimëkëmbjes, si dhe kohën dhe mënyrën e informimit të Bankës së Shqipërisë, mbi arritjen e treguesve;

ii) një përshkrim të detajuar të treguesve, që pasqyrojnë ndikimin e mundshëm në nivelin e kapitalit, situatën e likuiditetit, përfitueshmërinë dhe profilin e rrezikut të bankës ose subjekteve të përfshirë në planin e rimëkëmbjes;

h) përputhshmëria me sistemin e administrimit të rrezikut të bankës ose të grupit bankar, duke përfshirë edhe një përshkrim të kufijve përkatës të paralajmërimit të hershëm, të cilët janë pjesë e procesit të brendshëm të administrimit të rrezikut të bankës ose grupit dhe sigurojnë informacion për organet drejtuese mbi mundësinë e arritjes së treguesve;

i) sistemet e administrimit të informacionit, duke përfshirë edhe një përshkrim të mënyrës së sigurimit të informacionit të nevojshëm, në kohë dhe në mënyrë të besueshme, për zbatimin e masave të rimëkëmbjes.

NËNKREU I
TREGUESIT E RIMËKËMBJES

Neni 9
Kuadri i treguesve të rimëkëmbjes

1. Banka harton kuadrin e treguesve të rimëkëmbjes, si pjesë të rëndësishme të planit të rimëkëmbjes.

2. Treguesit e rimëkëmbjes janë tregues sasiorë dhe tregues cilësorë.

3. Banka, në kuadrin e treguesve të rimëkëmbjes, përfshin të gjithë treguesit sipas kategorive të aneksit nr. 1 të kësaj rregulloreje:

a) tregues të kapitalit;

b) tregues të likuiditetit;

c) tregues të përfitueshmërisë;

d) tregues të cilësisë së aktiveve;

e) tregues të tregut dhe makroekonomikë.

4. Banka, në rastet kur nuk përfshin në planin e rimëkëmbjes, tregues të tregut dhe

makroekonomikë, argumenton se këta tregues nuk kanë lidhje me strukturën ligjore, profilin e rrezikut, madhësinë dhe/ose kompleksitetin e saj.

5. Banka mund të përfshijë në planin e rimëkëmbjes edhe treguesit shtesë, sipas listës ilustruese të paraqitur në aneksin nr. 2 të kësaj rregulloreje ose tregues të tjerë, sipas vlerësimit të vetë bankës.

6. Banka, në hartimin e kuadrit të treguesve të rimëkëmbjes, siguron që ky kuadër:

a) përshtatet me modelin e biznesit dhe strategjinë e bankës, si dhe identifikon dobësitë kryesore që mund të ndikojnë në gjendjen financiare të bankës dhe që sjellin aktivizimin ose jo, të planit të rimëkëmbjes;

b) është i mjaftueshëm për madhësinë, kompleksitetin dhe profilin e rrezikut të bankës, si dhe në veçanti, numri i treguesve që do të përfshihen në plan është i mjaftueshëm për të paralajmëruar/sinjalizuar në kohë organet drejtuese të bankës, mbi përkeqësimin e situatës;

c) përcakton momentin, në të cilin banka duhet të vendosë, nëse duhet të ndërmarrë ose jo një veprim, siç përcaktohet në planin e rimëkëmbjes;

d) është i integruar dhe përputhet me sistemin e administrimit të rrezikut, duke përfshirë treguesit ekzistues të planit të emergjencës për likuiditetin dhe kapitalin, planit të vazhdimësisë së veprimtarisë, si dhe procedurat e përshkallë-zimit dhe të vendimmarrjes;

e) përfshin edhe tregues të orientuar nga e ardhmja/perspektiva (*forward-looking*).

7. Banka, gjatë përcaktimit të treguesve sasiorë të planit të rimëkëmbjes, përdor metodën e parametrave të përshkallëzuar, me qëllim që të sigurohet në çdo kohë informacioni për organet drejtuese, mbi mundësinë e arritjes së këtyre treguesve.

8. Banka i rikalibron treguesit e planit të rimëkëmbjes, të paktën një herë në vit dhe sa herë është e nevojshme, në mënyrë që të mundësojë sinjalizimin në kohë, duke konsideruar edhe madhësinë dhe shpejtësinë e thyerjes së kufijve të treguesve.

9. Banka argumenton/shpjegon mënyrën e kalibrimit dhe të përcaktimit të kufijve të këtyre treguesve.

10. Banka siguron që sistemet e administrimit të informacionit, mundësojnë lehtësisht monitorimin në vazhdimësi të treguesve nga ana e vetë bankës dhe paraqitjen në kohë të tyre (treguesve), sa herë që kërkohen nga Banka e Shqipërisë.

Neni 10

Treguesit e kapitalit

1. Banka, në përcaktimin/përzgjedhjen e treguesve të kapitalit, siguron që këta tregues të identifikojnë në vazhdimësi çdo përkeqësim të konsiderueshëm aktual apo që mund të ndodhë në të ardhmen, në nivelin dhe cilësinë e kapitalit.

2. Banka, gjatë përcaktimit/përzgjedhjes së treguesve të kapitalit, mban parasysh se kapaciteti i këtyre treguesve për të reaguar në kohën e duhur, mund të jetë më i ulët se për disa tregues të tjerë, si dhe disa masa për rivendosjen e nivelit të kapitalit të bankës mund të kërkojnë periudha më të gjata ekzekutimi apo të kenë ndjeshmëri më të madhe ndaj tregut dhe kushteve të tjera. Banka shqyrton mënyrat për të adresuar këto problematika, në veçanti, nëpërmjet krijimit të projeksioneve të kapitalit të orientuara nga e ardhmja (*forward-looking*), duke marrë në konsideratë afatin e maturimit kontraktual të instrumenteve të rëndësishme të kapitalit.

3. Banka përfshin treguesit e kapitalit edhe në Procesin e Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (PVBMK), si dhe në sistemin e saj të administrimit të rrezikut.

4. Banka kalibron kufijtë për treguesit e kapitalit, duke u bazuar në profilin e rrezikut të saj dhe në kohën e nevojshme për aktivizimin e masave të rimëkëmbjes, duke marrë parasysh kapacitetin e rimëkëmbjes, si rezultat i këtyre masave dhe se sa shpejt mund të ndryshojë niveli i kapitalit, duke konsideruar rrethanat individuale të bankës.

5. Banka kalibron në nivele të mjaftueshme kufijtë për treguesit e kapitalit, me qëllim që të sigurohet një kohë e mjaftueshme për aktivizimin e masave të rimëkëmbjes, për të siguruar ruajtjen e niveleve minimale të kërkuara të kapitalit dhe të kërkesave shtesë për rreziqet e tjera.

Neni 11

Treguesit e likuiditetit

1. Banka përcakton/përzgjedh treguesit e likuiditetit, të cilët i sigurojnë asaj sinjalizimin në kohë, për një përkeqësim aktual apo të mundshëm të kapacitetit të saj, për të plotësuar nevojat aktuale dhe të parashikuara për likuiditet dhe financim, për të siguruar zbatimin e kërkesave minimale rregullatore,

përfshirë edhe kërkesat shtesë për likuiditet.

2. Treguesit e likuiditetit u referohen nevojave afatshkurtra e afatgjata të bankës për likuiditet dhe financim dhe përfshijnë edhe mbështetjen e bankës në tregun ndërbankar dhe në depozitat e klientëve, sipas monedhave të ndryshme.

3. Banka integron dhe përshtat treguesit e likuiditetit, me strategjitë, politikat, proceset dhe sistemet e saj, si dhe me sistemin e administrimit të rrezikut.

4. Treguesit e likuiditetit konsiderojnë gjithashtu edhe nevoja të tjera të mundshme për likuiditet dhe financim, të tilla si marrëveshjet e financimit brenda grupit dhe zërat jashtë bilancit.

5. Banka kalibron kufijtë për treguesit e likuiditetit, bazuar në profilin e rrezikut të saj, kohën e nevojshme për të aktivizuar masat e rimëkëmbjes dhe në kapacitetin e rimëkëmbjes.

Neni 12

Treguesit e përfitueshmërisë

1. Treguesit e përfitueshmërisë përfshijnë aspektet më të rëndësishme që lidhen me burimet kryesore të të ardhurave dhe shpenzimeve të bankës, luhatja e të cilave mund të çojë në një përkeqësim të shpejtë të gjendjes financiare të saj, për shkak të ndikimit në kapitalin e bankës.

2. Banka përfshin në këtë kategori edhe tregues që u referohen humbjeve që rrjedhin nga rreziku operacional ose rreziku i kredisë, të cilat mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm në pasqyrën e fitimit dhe humbjes.

Neni 13

Treguesit e cilësisë së aktiveve

1. Banka përcakton treguesit e cilësisë së aktiveve, të cilët i sigurojnë asaj sinjalizimin në kohë, për rastet e përkeqësimit të cilësisë së aktiveve, që mund të sjellin ndërmarrjen nga banka të një veprimi të përshkruar në planin e rimëkëmbjes.

2. Treguesit e cilësisë së aktiveve mund të përfshijnë si gjendjen (tepricën), edhe ecurinë e ekspozimeve me probleme, me qëllim që të sigurojnë identifikimin e nivelit dhe të dinamikës së tyre.

3. Treguesit e cilësisë së aktiveve përfshijnë edhe ekspozimet jashtë bilancit që lidhen me kreditë me probleme dhe ndikimin e tyre në cilësinë e aktiveve.

Neni 14

Treguesit e tregut dhe makroekonomikë

1. Treguesit e tregut identifikojnë pritshmëritë e pjesëmarrësve të tregut për një përkeqësim të shpejtë të gjendjes financiare të bankës, që mund të çojë në vështirësi të sigurimit të financimit apo pjesëmarrjes në tregjet e kapitalit.

2. Banka, në përputhje me kërkesat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, mund të përfshijë në kategorinë e treguesve të tregut, koston e borxhit afatgjatë, përkeqësimin e vlerësimeve (afatshkurtra dhe/ose afatgjata), të cilat reflektojnë pritshmëritë e agjencive të vlerësimit, që çojnë në ndryshime të shpejta edhe në pritshmëritë e pjesëmarrësve të tregut mbi gjendjen financiare të bankës etj.

3. Treguesit makroekonomikë identifikojnë sinjale të përkeqësimit të kushteve ekonomike të vendit ku banka ushtron veprimtarinë ose të vendit ku ka përqendrim të ekspozimeve apo financimeve të saj.

4. Treguesit makroekonomikë të parashikuar në pikën 3 të këtij neni, mund të përfshijnë tipologjitë e treguesve të mëposhtëm:

a) treguesit makroekonomikë gjeografikë, që lidhen me vende (juridiksione) të ndryshme ndaj të cilave banka është e ekspozuar, duke marrë në konsideratë edhe rreziqet që rrjedhin nga pengesat e mundshme ligjore;

b) treguesit makroekonomikë sektorialë, që lidhen me sektorët e veçantë më të mëdhenj të aktivitetit ekonomik, ndaj të cilëve banka është e ekspozuar.

NËNKREU II
ANALIZA STRATEGJIKE

Neni 15

Analiza strategjike

1. Banka, në analizën strategjike identifikon veprimtaritë kryesore (linjat kryesore të biznesit) dhe funksionet kritike, si dhe përcakton hapat kryesorë që ndiqen për të ruajtur vazhdimësinë e këtyre

veprimtarive dhe të funksioneve kritike, në kushtet e një situate të përkeqësimit të gjendjes financiare.

2. Banka, në analizën strategjike, përfshin elementet e mëposhtme:

a) një përshkrim të saj dhe të subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes; dhe

b) një përshkrim të masave të rimëkëmbjes.

Neni 16

Subjektet e planit të rimëkëmbjes

1. Banka, në përputhje me kërkesat e pikës 2, shkronja "a" të nenit 15 të kësaj rregulloreje, si pjesë të analizës strategjike, përgatit edhe një përshkrim të saj dhe të subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes, i cili përmban informacionin e mëposhtëm:

a) një përshkrim të përgjithshëm të elementeve të mëposhtme për bankën dhe subjektet e grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes:

i) strategjia e biznesit dhe strategjia e rrezikut të tyre;

ii) modeli dhe plani i biznesit, së bashku me një listë të vendeve (juridiksioneve) kryesore ku ushtrojnë veprimtarinë, duke përfshirë edhe nëpërmjet një subjekti të rëndësishëm të grupit ose dege të rëndësishme të bankës;

iii) veprimtaritë kryesore (linjat kryesore të biznesit) dhe funksionet kritike;

iv) procesi/metodologjia dhe parametrat për identifikimin e veprimtarive kryesore (linjave kryesore të biznesit) dhe të funksioneve kritike;

b) shpërndarjen e veprimtarive kryesore (linjave kryesore të biznesit) dhe të funksioneve kritike, ndërmjet degëve të rëndësishme të bankës dhe subjekteve të rëndësishme të grupit;

c) një përshkrim të detajuar të strukturës ligjore dhe financiare të bankës dhe të subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes, së bashku me një përshkrim të ndërlidhjes brenda grupit dhe në veçanti një përshkrim të elementeve të mëposhtme:

i) të të gjitha ekspozimeve të rëndësishme ekzistuese dhe të marrëdhënieve të financimit brenda grupit, të flukseve të kapitalit midis subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes, të garancive ekzistuese brenda grupit ose garancive që pritet të hyjnë në fuqi, në momentin kur aktivizohet plani i rimëkëmbjes;

ii) të ndërlidhjes operacionale, në lidhje me funksionet, të cilat janë të përqendruara në një subjekt të grupit ose degë të bankës, që janë të rëndësishme për funksionimin e subjekteve të tjera të grupit, degëve të bankës ose grupit bankar dhe veçanërisht, funksionet e centralizuara të teknologjisë së informacionit, funksionet e thesarit, funksionet e administrimit të rrezikut ose funksionet administrative;

iii) të çdo marrëveshjeje ekzistuese për mbështetje financiare brenda grupit, duke përfshirë palët e marrëveshjes, formën e mbështetjes financiare, si dhe kushtet për përfitimin e mbështetjes financiare.

d) një përshkrim të ndërlidhjes së jashtme, që përfshin minimalisht:

i) ekspozimet dhe detyrimet kryesore ndaj kundërpartive kryesore;

ii) produktet dhe shërbimet financiare kryesore, të ofruara nga banka dhe subjektet e grupit të përfshirë në planin e rimëkëmbjes, ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregjeve financiare;

iii) shërbimet kryesore që palët e treta ofrojnë ndaj bankës dhe subjekteve të grupit të përfshirë në planin e rimëkëmbjes.

Neni 17

Masat e rimëkëmbjes

1. Seksioni mbi masat e rimëkëmbjes, përfshin një listë të të gjitha masave të rimëkëmbjes, të identifikuara për t'iu përgjigjur skenarëve të përkeqësimit të gjendjes financiare, me qëllim ruajtjen ose rivendosjen e qëndrueshmërisë dhe të pozicionit financiar të bankës dhe subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes.

2. Banka, në listën e masave të rimëkëmbjes, përveç masave të natyrës së jashtëzakonshme, përfshin edhe masa, të cilat mund të merren në kushte normale të veprimtarisë të bankës dhe të subjekteve të

grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes.

3. Masat e rimëkëmbjes përfshijnë edhe ato masa, të cilat mund të kërkojnë ndryshime në natyrën e biznesit të bankës ose subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes.

4. Banka, për çdo masë rimëkëmbjeje, përcakton afatin e pritshëm kohor për zbatimin e saj.

5. Masat e identifikuara nga banka duhet t'i përkasin minimalisht njërës nga kategoritë e mëposhtme:

a) tërësisë së veprimeve që lidhen me kapitalin dhe likuiditetin, të cilët kanë si objektiv kryesor sigurimin e qëndrueshmërisë së funksioneve kritike dhe të veprimtarive kryesore (linjave kryesore të biznesit), me qëllim ruajtjen dhe/ose rivendosjen e qëndrueshmërisë dhe të pozicionit financiar të bankës ose të subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes;

b) marrëveshjeve dhe masave, të cilat kanë si objektiv kryesor ruajtjen ose rivendosjen e nivelit të kapitalit rregullator të bankës ose të grupit, nëpërmjet rikapitalizimit të jashtëm dhe masave të brendshme, me qëllim përmirësimin e nivelit të kapitalit të bankës ose subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes;

c) marrëveshjeve dhe masave, të cilat sigurojnë se banka ose subjektet e grupit bankar që përfshihen në planin e rimëkëmbjes, kanë akses të mjaftueshëm në burimet e financimit në raste emergjence, për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë dhe për të përmbushur detyrimet që maturohen (këto masa përfshijnë masa të jashtme, si dhe aty ku është e mundur, masa që synojnë transferimin e likuiditetit brenda grupit);

d) marrëveshjeve dhe masave për të reduktuar rrezikun ose për të ristrukturuar veprimtaritë (linjat e biznesit), duke përfshirë aty ku është e mundur, një analizë të mundësive të shitjes së aktiveve, subjekteve të grupit ose linjave të biznesit;

e) marrëveshjeve dhe masave, të cilat kanë si qëllim kryesor arritjen e një ristrukturimi nga vetë banka të borxhit/detyrimeve, me kusht që të mos shkaktojë një ngjarje aktivizuese (*trigger event*) të paaftësisë paguese, të zgjidhjes së marrëveshjeve ekzistuese, të uljes të nivelit të vlerësimit të bankës ose të një ngjarjeje të ngjashme me to.

6. Banka, në rastet kur masat e rimëkëmbjes nuk përfshijnë ndonjë nga veprimet, marrëveshjet apo masat e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, paraqet një shpjegim në këtë seksion të planit të rimëkëmbjes, se këto veprime, marrëveshje apo masa, janë marrë në konsideratë në mënyrë të mjaftueshme nga banka mëmë ose subjekte të tjera të grupit që kanë përgatitur dhe paraqitur planin, në autoritetin mbikëqyrës të vendit ku ushtrojnë veprimtarinë.

Neni 18

Vlerësimi i efektit të masave të rimëkëmbjes

1. Çdo masë rimëkëmbjeje përfshin edhe një vlerësim të efektit të saj, në veçanti, një përshkrim të detajuar të procesit të përcaktimit të vlerës dhe tregtueshmërisë së veprimtarive kryesore (linjave kryesore të biznesit), operacioneve dhe aktiveve të bankës dhe të subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, vlerësimi i efektit të masës së rimëkëmbjes përfshin edhe elementet e mëposhtme:

a) një vlerësim të efektit financiar dhe operacional, që përcakton ndikimin e pritshëm në aftësinë paguese, likuiditetin, përfitueshmërinë dhe veprimtarinë e bankës dhe të subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes. Aty ku është e mundur, vlerësimi duhet të identifikojë qartë subjektet e ndryshme të grupit, që mund të ndikohen nga masa ose që do të përfshihen në zbatimin e saj;

b) një vlerësim të efektit të jashtëm dhe të pasojave sistemike, që përcakton ndikimin mbi funksionet kritike që kryhen nga banka ose subjektet e grupit bankar, të përfshirë në planin e rimëkëmbjes, si dhe efektin mbi aksionarët, klientët dhe kundërpartitë;

c) supozimet e përdorura për qëllime të vlerësimit të pikave "a" dhe "b", duke përfshirë tregtueshmërinë e aktiveve ose sjelljen e bankave dhe subjekteve të tjera financiare.

Neni 19

Vlerësimi i zbatueshmërisë së masave të rimëkëmbjes

1. Çdo masë rimëkëmbjeje, duhet të përmbajë edhe një vlerësim të zbatueshmërisë në praktikë të saj, që përfshin:

a) një vlerësim të rrezikut të lidhur me masën e rimëkëmbjes, duke u bazuar në ndonjë eksperiencë të mëparshme të zbatimit të kësaj mase ose të një mase të barasvlershme me të;

b) një analizë dhe përshkrim të detajuar të çdo pengese të rëndësishme për zbatimin efektiv dhe në kohë të planit dhe një përshkrim të mënyrës se si do të kapërcehen këto pengesa.

Neni 20

Vazhdimësia e veprimtarisë së bankës

1. Banka, për çdo masë rimëkëmbjeje, kryen edhe një vlerësim të mënyrës së sigurimit të vazhdimësisë së veprimtarisë, në rastet kur do të zbatohet kjo masë rimëkëmbjeje.

2. Vlerësimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, konsideron:

a) marrëveshjet apo masat e nevojshme për sigurimin e një aksesi të vazhdueshëm në infrastrukturën e tregjeve financiare;

b) marrëveshjet apo masat e nevojshme për sigurimin e funksionimit të vazhdueshëm të proceseve operacionale të bankës dhe të subjekteve të grupit, që përfshihen në planin e rimëkëmbjes, duke përfshirë infrastrukturën dhe shërbimet e teknologjisë së informacionit;

c) kohën e nevojshme për zbatimin dhe efektivitetin e planit të rimëkëmbjes;

d) efektivitetin e masave të rimëkëmbjes dhe mjaftueshmërinë e treguesve, në rastin e skenarëve të përkeqësimit të gjendjes financiare, që vlerësojnë efektin e çdo skenari mbi subjektet që përfshihen në planin e rimëkëmbjes, në veçanti, mbi kapitalin, likuiditetin, përfitueshmërinë, profilin e rrezikut dhe veprimtarinë e tyre.

3. Vlerësimi përcakton masat e rimëkëmbjes, që mund të jenë më të përshtatshme për një skenar të caktuar, bazuar në efektin e mundshëm dhe zbatueshmërinë e tyre.

4. Vlerësimi i bazuar në këtë informacion, duhet të përshkruajë kapacitetin e përgjithshëm të rimëkëmbjes të bankës ose subjekteve të grupit bankar që përfshihen në planin e rimëkëmbjes, duke përfshirë edhe shkallën në të cilën masat e rimëkëmbjes e lejojnë bankën ose subjektet e tjera të grupit të rimëkëmben, në rastet e skenarëve të përkeqësimit të gjendjes makroekonomike e financiare.

NËNKREU III

SKENARËT

Neni 21

Skenarët

1. Banka harton të paktën tre skenarë, për një ngjarje sistemike, një ngjarje specifike dhe një kombinim të të dyjave.

2. Çdo skenar bazohet në ngjarje, të cilat përmbushin secilën prej kërkesave të mëposhtme:

a) kanë ndikim të rëndësishëm te banka ose grupi bankar, duke konsideruar minimalisht: modelin e biznesit dhe të financimit të bankës, veprimtaritë dhe strukturën e grupit, madhësinë ose ndërlidhjen e saj me bankat e tjera ose me sistemin financiar në tërësi dhe, në veçanti, dobësitë e identifikuara të bankës ose të grupit bankar;

b) mund të shkaktojnë paaftësi paguese të bankës ose të grupit, nëse nuk zbatohen masat e rimëkëmbjes në kohën e duhur; dhe

c) janë të jashtëzakonshme, por të mundshme për të ndodhur.

3. Çdo skenar përfshin një vlerësim të ndikimit të ngjarjeve, në të paktën një nga elementet e mëposhtme të bankës ose grupit:

a) kapitalin në dispozicion;

b) likuiditetin në dispozicion;

c) profilin e rrezikut;

d) përfitueshmërinë;

e) operacionet, duke përfshirë operacionet e pagesave dhe të shlyerjes;

f) reputacionin.

4. Banka përdor *stress-test*-in e anasjelltë, në rastet kur ndërton skenarë që parashikojnë ta çojnë bankën pranë një situate të paaftësisë paguese, nëse nuk do të zbatoheshin me sukses masat e rimëkëmbjes.

5. Banka përcakton numrin e skenarëve, në përputhje me natyrën e veprimtarisë, madhësinë, ndërlidhjen me bankat e tjera dhe me sistemin financiar në tërësi, si dhe me modelin e saj të financimit.

6. Skenarët përfshijnë si ngjarje të pafavorshme që mund të ndodhin gradualisht, ashtu edhe ngjarje të pafavorshme që mund të ndodhin menjëherë.

7. Banka, në hartimin e skenarëve të bazuar në ngjarje sistemike, merr në konsideratë të paktën një prej ngjarjeve të mëposhtme:

a) vështirësi financiare/paaftësi paguese e bankave me rëndësi sistemike, që ndikojnë në stabilitetin financiar;

b) një rënie të likuiditetit në dispozicion, në tregun e huadhënies ndërbankare;

c) rritjen e rrezikut të vendit dhe rritjen e flukseve dalëse të kapitalit;

d) lëvizjet e pafavorshme në çmimin e aktiveve në një ose disa tregje;

e) përkeqësimin e treguesve makroekonomikë;

f) etj.

8. Banka, në hartimin e skenarëve të bazuar në ngjarje specifike, merr në konsideratë të paktën një prej ngjarjeve të mëposhtme:

a) vështirësi financiare/paaftësi paguese të:

i) kundërpartive të rëndësishme të bankës;

ii) grupit bankar, pjesë e të cilit është banka; dhe/ose

iii) bankës mëmë apo filialeve të saj;

b) dëmtimin e reputacionit të bankës ose grupit;

c) rritjen e flukseve dalëse të likuiditetit;

d) lëvizjen e pafavorshme në çmimet e aktiveve, të cilat kanë një peshë të rëndësishme në bilancin e bankës ose grupit;

e) humbjet e konsiderueshme nga aktiviteti i kredisë;

f) humbjet e konsiderueshme operacionale;

g) etj.

Neni 22

Plani i komunikimit dhe informimit

I. Plani i komunikimit dhe informimit është një plan i detajuar, i cili përfshin çështjet e mëposhtme:

a) përshkrimin e procesit të komunikimit të brendshëm me punonjësit e bankës;

b) përshkrimin e procesit të komunikimit të jashtëm, në veçanti me aksionarët dhe investitorët e tjerë, autoritetet mbikëqyrëse, kundërpartitë, tregjet financiare, depozituesit dhe publikun e gjerë;

c) përshkrimin e masave që do të ndërmerren për të administruar reagimet e mundshme negative të tregut dhe strukturat që do të angazhohen për administrimin e këtyre situatave;

d) përcaktimin e mënyrës së njoftimit dhe personave përgjegjës për informimin e Bankës së Shqipërisë, në kohën e duhur dhe në mënyrë të plotë, mbi ndodhjen e ngjarjeve që aktivizojnë planin e rimëkëmbjes, si dhe masat aktuale të rimëkëmbjes dhe përshkallëzimin e tyre të mundshëm.

2. Plani i komunikimit dhe informimit konsideron, nëse për ndonjë nga masat e rimëkëmbjes, nevojitet një komunikim specifik.

Neni 23

Masat parapërgatitore

1. Plani i rimëkëmbjes përfshin një analizë të çdo mase parapërgatitore, që është e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e planit të rimëkëmbjes ose për të përmirësuar efektivitetin e tij, si dhe një afat kohor për zbatimin e këtyre masave parapërgatitore.

2. Masa të tilla përfshijnë masat e nevojshme për të kaluar çdo pengesë, në zbatimin me efektivitet të masave të rimëkëmbjes, të cilat janë identifikuar në planin e rimëkëmbjes.

Neni 24

Kërkesa për planet e thjeshtuara të rimëkëmbjes

1. Bankat me rëndësi josistemike, përveç sa përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, zbatojnë të gjitha kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Bankat me rëndësi josistemike, nëse nuk kërkohet ndryshe nga Banka e Shqipërisë, paraqesin plane të thjeshtuara të rimëkëmbjes. Këto plane përmbajnë të gjithë informacionin e kërkuar në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, me përjashtim të:

a) kuadrit të treguesve: në të cilin banka përfshin të paktën një tregues nga çdo kategori e treguesve (siç përcaktohet në aneksin nr. 1 dhe/ose aneksin nr. 2);

b) skenarëve: banka zhvillon të paktën një skenar, i cili bazohet në një ngjarje specifike ose në një ngjarje sistemike.

KREU III
KËRKESA RAPORTUESE DHE MBIKËQYRËSE

Neni 25
Kërkesa raportuese dhe mbikëqyrëse

1. Bankat paraqesin planet e rimëkëmbjes pranë Bankës së Shqipërisë çdo vit, jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë të vitit, në të cilat përfshijnë informacionin cilësor dhe sasior sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe siç përcaktohet në aneksin nr. 3 dhe aneksin nr. 4 të saj.

2. Banka mbizotëruese në një grup bankar, paraqet planin e rimëkëmbjes së grupit bankar, sipas kërkesave të pikës 1 të këtij neni.

Ndikimi mbi humbjet e konsiderueshme nga rreziku i kredisë	*Në mln lekë*						
Ndikimi mbi normën e rritjes së kredive me probleme bruto	*Përqindje*						
Ndikimi mbi raportin e fondeve rezervë/totalit të kredive me probleme	*Përqindje*						
Ndikimi mbi vlerësimet (ratings) të bankës	*Po/Jo*						
Ndikimi mbi koston e borxhit afatgjatë	*Përqindje*						

Ndikimi mbi treguesit shtesë, jo të detyrueshëm, specifikë të bankës	Njësitë	Vlera në datën e referencës së planit	3 muaj	1 vit	Koha deri në thyerjen e treguesit (muaj)*	Koha deri pranë paaftësisë paguese (muaj)**	Komente
Për t'u përshtatur me treguesit e Aneksit nr. 2 të rregullores							

*Ju lutemi përfshini numrin e muajve deri në thyerjen e treguesit. Nëse sipas skenarit, nuk ndodh një thyerje e treguesit, qeliza duhet të lihet bosh.

**Çdo skenar duhet të ndërtohet për ta çuar bankën pranë një situate paaftësie paguese, ku të paktën një nga kufijtë rregullatorë duhet të thyhet. Ju lutemi shënoni numrin e muajve derisa kjo thyerje të ndodhë (nëse nuk do të zbatohen masat). Në rast se nuk thyhet asnjë kufi rregullator, qeliza duhet të lihet bosh.

Formulari nr. 4. Skenari A (lista specifike e masave të rimëkëmbjes nën skenarë të ndryshëm)

Lista specifike e masave të rimëkëmbjes nën skenarë të ndryshëm

supozim: situata si në skenarin e përdorur në F3

Ju lutem përdorni numra pozitivë për rritje dhe numra negativë për rënie

Treguesit shtesë

Nr.	Masa e rimëkëmbjes (emri i përdorur në planin e rimëkëmbjes)	Kategoria	Zbatueshmëria e masës	Koha e materializimit të efektit	Ndikimi mbi raportin e kapitalit bazë të nivelit të parë	Ndikimi mbi kapitalin bazë të nivelit të parë	Ndikimi mbi raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit	Ndikimi mbi kapitalin rregullator	Ndikimi mbi ekspozimet e ponderuara me rrezikun	Ndikimi mbi treguesin total të likuiditetit	Ndikimi mbi treguesin e likuiditetit në lekë	Ndikimi mbi treguesin e likuiditetit në valutë	Ndikimi mbi tërheqjen ditore të depozitave me afat	Ndikimi mbi kthimin nga aktivet	Ndikimi mbi kthimin nga kapitali	Ndikimi mbi humbjet operacionale	Ndikimi mbi humbjet nga rreziku i kredisë	Ndikimi mbi normën e rritjes së kredive me probleme bruto	Ndikimi mbi raportin e fondeve rezervë/totalit të kredive me probleme	Ndikimi mbi vlerësimet (ratings) të bankës	Ndikimi mbi koston e borxhit afatgjatë të bankës	Komente dhe supozime	Për t'u përshtatur me treguesit e Aneksit nr. 2 të rregullores	0	0	0
Nr.	*Emri*	*Emri i kategorisë*	*Zbatueshmëria e masës*	*Muaj*	*Përqindje*	*Mln lekë*	*Përqindje*	*Mln lekë*	*Mln lekë*	*Përqindje*	*Përqindje*	*Përqindje*	*Përqindje*	*Përqindje*	*Përqindje*	*Përqindje*	*Përqindje*	*Përqindje*	*Përqindje*	*Po/Jo*	*Përqindje*		*0*	*0*	*0*	*0*
1																										
2																										
3																										
4																										
5																										
6																										
7																										
8																										
9																										
10																										
11																										
12																										
13																										
14																										
15																										
16																										
17																										
18																										
19																										
20																										
21																										
22																										
23																										
24																										
25																										
26																										
27																										
28																										
29																										
30																										
31																										
32																										
33																										
34																										
35																										
36																										
37																										
38																										
39																										
40																										
41																										
42																										
43																										
44																										
45																										
46																										
47																										
48																										
49																										
50																										

Shënime shpjeguese për plotësimin e formularëve të aneksit nr. 3, për raportimin e informacionit cilësor të planit të rimëkëmbjes

Formulari nr. 3. Subjekte të rëndësishme të grupit ose degë të rëndësishme të bankës

Shënime shpjeguese sipas kolonave specifike:

Kolonat	Referenca ligjore dhe udhëzimet
010-020	**Subjekti i grupit**
010	**Emri i subjektit**
020	**Struktura ligjore** Lloji i licencës (për shembull: bankë, degë e bankës, subjekt financiar jobankë etj.)
030	**Aksionari i drejtpërdrejtë** Emri i subjektit që zotëron një pjesëmarrje dhe kontroll të drejtpërdrejtë në subjektin e grupit të listuar në kolonën 010.
040	**Banka mbizotëruese ose institucioni që kryen konsolidimin** Emri i bankës mbizotëruese të grupit bankar/financiar sipas përcaktimeve në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" ose emri i institucionit që kryen konsolidimin e subjektit të listuar në kolonën 010, në rastin kur banka është pjese e grupit bankar/financiar të huaj.
050	**Kapitali (%)** Përqindja e kapitalit e mbajtur nga subjekti i grupit i listuar në kolonën 030, në subjektin e grupit të listuar në kolonën 010.
060	**Të drejtat e votës (%)** Përqindja e të drejtave të votës të zotëruara nga subjekti i grupit i listuar në kolonën 030, në subjektin e grupit të listuar në kolonën 010.
070	**Kontributi në të ardhurat e grupit/bankës** Kontributi (i shprehur në milionë lekë) i subjektit të listuar në kolonën 010, në të ardhurat e grupit ose të bankës.
080	**Pesha ndaj të ardhurave totale (%)** Kontributi (i shprehur në përqindje) i subjektit të listuar në kolonën 010 në të ardhurat e grupit ose të bankës.
090	**Kryen veprimtari kryesore për grupin/bankën** Listoni veprimtaritë kryesore të kryera nga subjekti për grupin/bankën.
100	**Kryen në mënyrë të përqendruar funksione bazë** Listoni funksionet bazë të kryera nga subjekti në mënyrë të përqendruar.
110	**Mbart/zbut rreziqet kryesore për grupin ose bankën** Listoni rreziqet që mbarten ose zbuten nga subjekti.
120	**Shitja/likuidimi i subjektit ekspozon grupin/bankën ndaj rreziqeve të rëndësishme** Listoni rreziqet ndaj të cilave është ekspozuar grupi/banka.
130	**Vendi ku ushtron veprimtarinë** Identifikimi i vendeve ku ushtron veprimtarinë subjekti i listuar në kolonën 010.
140	**Rëndësia për stabilitetin financiar** Tregoni me "Po" ose "Jo" nëse subjekti është i rëndësishëm për stabilitetin financiar të vendit.
150	**Subjekt i rëndësishëm i grupit/degë e rëndësishme e bankës** Tregoni me "Po" ose "Jo", nëse subjekti i listuar në kolonën 010, është subjekt i rëndësishëm i grupit apo degë e rëndësishme e bankës.

Formulari nr. 4. Ndërlidhjet e jashtme

4/1 Ndërlidhjet e jashtme (Aktivet)

Në këtë tabelë, në përgjithësi, duhet të ketë një rresht për secilën nga 10 kundërpartitë kryesore. Megjithatë, kur ekspozimi total ndaj një kundërpartie përbëhet nga ekspozime në disa monedha, kjo duhet të ndahet në rreshta të veçantë, ku shuma e ekspozimeve në rreshtat e veçantë, i shtohet ekspozimit total ndaj kundërpartisë.

Shënime shpjeguese sipas kolonave specifike:

Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet
010	**Subjekti**
020	**10 Kundërpartitë kryesore** Kufiri për të përcaktuar nëse një kundërparti konsiderohet ose jo kryesore, duhet të përcaktohet nga vetë banka. Kundërpartitë duhet të raportohen për grupet e personave të lidhur dhe në rast se klienti nuk i përket një grupi personash të lidhur, do të raportohet në nivel individual. Siç u sqarua edhe më sipër, një kundërparti mund të renditet disa herë në këtë formular, nëse ekspozimi total është i përbërë nga ekspozime në monedha të ndryshme.
030	**Vendi ku ushtron veprimtarinë** Tregoni vendin ku ushtron veprimtarinë kundërpartia e listuar në kolonën 020.
040	**Monedha** Kjo duhet të jetë monedha origjinale e ekspozimit.
050	**Ekspozimi total (në mln lekë)** Shumat e ekspozimit duhet të raportohen në milionë lekë. Kur monedha origjinale nuk është lek, vlera duhet të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të datës së raportimit.
060	**Zbutja e rrezikut të kredisë** Zbutja e rrezikut të kredisë (CRM), siç përcaktohet në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit", raportohet në milionë lekë. Për qëllime të këtij formulari, do të përdoret teknika e zbutjes së rrezikut të kredisë, e përdorur/njohur edhe për qëllime të raportimit të mjaftueshmërisë së kapitalit.
070	**Rregullimi i vlerës dhe fondet rezervë** Rregullimi i vlerës dhe fondet rezervë, siç përcaktohen në nenin 9, të rregullores "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit", raportohen në milionë lekë.
080	**Ekspozimi neto** 080 = 050 – 060 – 070
090	**Ekspozimi total/Aktivet totale të grupit** Raporti i ekspozimit total ndaj një kundërpartie, me aktivet totale të grupit bankar ose të bankës.

4/2 Ndërlidhjet e jashtme (detyrimet)

Në këtë tabelë, në përgjithësi, duhet të ketë një rresht për secilën nga 10 kundërpartitë më kryesore. Megjithatë, kur detyrimi total ndaj një ofruesi të fondeve/financimeve përbëhet nga detyrime në disa monedha, kjo duhet të ndahet në rreshta të veçantë, ku shuma e detyrimeve në rreshtat e veçantë, i shtohet detyrimit total ndaj kundërpartisë.

Shënime shpjeguese sipas kolonave specifike:

Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet
010	**Subjekti**
020	**10 Kundërpartitë kryesore** Kufiri për të përcaktuar nëse një kundërparti konsiderohet ose jo kryesore, duhet të përcaktohet nga vetë banka. Siç u sqarua edhe më sipër, një kundërparti mund të renditet disa herë në këtë formular, nëse ekspozimi total është i përbërë nga ekspozime në monedha të ndryshme.
030	**Vendi ku ushtron veprimtarinë** Tregoni vendin ku ushtron veprimtarinë kundërpartia e listuar në kolonën 020
040-070	**Financimi**
040	**Monedha** Kjo duhet të jetë monedha origjinale e detyrimit.
050	**Financimi total** I shprehur në milionë lekë.
060	**Lloji i financimit** Lloji i financimit, i cili duhet specifikuar (depozitë, obligacion etj.)
070	**Detyrimi/Detyrimet totale të grupit**

Formulari nr. 5. Funksionet kritike

Funksionet kritike duhet të përcaktohen nga vetë subjekti raportues, në përputhje me modelin individual të biznesit dhe me strukturën organizative, duke marrë parasysh përkufizimin e funksionit kritik të dhënë në Ligjin nr. 133/2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka" .

Si pikënisje, të gjitha funksionet ekonomike ose analitike të kryera nga banka duhet të raportohen dhe secili prej tyre, duhet të vlerësohet për kritikalitetin (nëse është kritik ose jo). Bankat duhet të hartojnë metodologji të brendshme për përcaktimin e funksioneve ekonomike dhe vlerësimin e kritikalitetit të tyre.

Banka duhet të marrë parasysh funksionet e mëposhtme ekonomike, gjatë përcaktimit të funksioneve kritike:

Pranimi i depozitave (aty ku është e mundur) mund të ndahet në llogari rrjedhëse dhe llogari kursimi të individëve dhe të bizneseve (duke ndarë mundësisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të) nga shoqëritë tregtare (korporatat)), llogari rrjedhëse/kursimi në monedhë vendase dhe në monedhë të huaj, llogari rrjedhëse/kursimi të klientëve vendas (rezidentë) dhe të huaj (jorezidentë), llogari rrjedhëse/kursimi të institucioneve financiare dhe të sektorit publik (qeverive qendrore apo rajonale ose autoriteteve lokale).

Kredidhënia (aty ku është e mundur) mund të ndahet në kredi ndaj individëve dhe ndaj shoqërive tregtare (korporatave) (duke ndarë mundësisht SME-të nga shoqëritë tregtare), kredi hipotekare dhe lloje të tjera të kredive (sipas ndarjes së vetë bankës), kredi në monedhë vendase dhe në monedhë të huaj, kredi brenda vendit dhe jashtë territorit të vendit ku ushtron veprimtarinë, kredi sindikatë, kredi ndaj institucioneve financiare dhe ndaj sektorit publik (qeverive qendrore apo rajonale ose autoriteteve lokale).

Shërbimet e pagesave, shërbime me *cash*-in, të shlyerjes, klerimit dhe marrjes në kujdestari (aty ku është e mundur) duhet të ndahen në shërbime pagesash për individët dhe bizneset, pagesa ndërbankare (banka korrespondente), forma të ndryshme pagesash (p.sh. në letër, elektronike), pagesa në monedhën vendase dhe në monedhë të huaj, furnizimi me *cash* (ATM, degë), shlyerja e titujve, shërbimi i klerimit të titujve (mundësisht të ndara midis shërbimeve për klientët e bankës kundrejt shërbimeve si ndërmjetës për bankat e tjera), shërbimet e marrjes në kujdestari etj.

Tregjet e kapitalit (aty ku është e mundur) duhet të ndahen në tregje primare (nënshkrimi dhe emetimi i titujve dhe, më tej, mund të ndahen sipas llojit të produktit, p.sh. tituj borxhi dhe tituj kapitali) dhe tregje sekondare/dytësore (nëse është e mundur, të ndahen sipas titujve: të kapitalit, të kredisë, derivativët), administrimi i aktiveve etj.

Financimi në tregun ndërbankar: (aty ku është e mundur), duhet të ndahen në marrëveshje të riblerjes, huamarrje ndërbankare, huadhënie ndërbankare, huadhënie dhe huamarrje e titujve, huadhënie me marzhe dhe derivativë, veprime me letrat tregtare etj.

Bankat duhet të përpiqen t'i plotësojnë rreshtat dhe të tregojnë në kolonën 420 nëse e konsiderojnë një ndarje të mundshme (në funksione analitike), si një funksion të veçantë në rastin e tyre (nëse jo, N/A duhet të zgjidhet në këtë kolonë dhe në kolonën 430 të sqarojnë se pjesë e cilit funksion është ky rresht). Funksionet ekonomike/analitike që paraqiten në formular, nuk duhet të interpretohen si një listë e detyrueshme e funksioneve, por kanë natyrë ilustruese dhe orientuese për bankën. Bankat duhet të vlerësojnë nivelin e detajimit, sipas rrethanave të tyre specifike dhe të raportojnë vetëm rreshtat që lidhen me to. Kjo mund të sjellë kombinimin e disa funksioneve analitike në një funksion të vetëm ekonomik (p.sh. mund të mos paraqitet ndarja sipas monedhës ose sipas rezidencës, por gjithashtu mund të fshihen SME-të si një funksion analitik, nëse SME-të mbulohen nga shërbimet e kredidhënies/ depozitave të segmenteve të tjerë). Nëse banka gjykon se duhet të sigurojë një detajim të mëtejshëm për funksione të veçanta, ajo mund të shtojë rreshta të tjerë në formular, sipas nevojës.

Udhëzime për plotësimin e kolonave specifike:

Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet
010	**Funksionet ekonomike/funksionet analitike** Këto funksione përfshijnë, por nuk kufizohen në "funksionet kritike" sipas nenit 4 (18) të Ligjit Nr. 133/2016. Bankat duhet të listojnë të gjitha funksionet ekonomike apo funksionet analitike që kryejnë dhe të përcaktojnë funksionet kritike në kolonën 420.
020	**Veprimtaritë kryesore (linjat kryesore të biznesit)** Banka liston veprimtaritë kryesore sipas nenit 4(48) të ligjit nr. 133/2016, të cilat i korrespondojnë funksioneve ekonomike/funksioneve analitike të listuara në kolonën 010.
030-040	**Subjekti**
030	**Emri i subjektit**
040	**Kodi identifikues i subjektit** Kodi 20-shifror alfa-numerik i subjektit të identifikuar në kolonën 030. Kodi identifikues i subjektit të grupit, identifikon në mënyrë unike çdo subjekt juridik ose strukturë që është pjesë e një transaksioni financiar, në çdo juridiksion. Në rastet kur "kodi identifikues i subjektit" nuk është i disponueshëm për një subjekt të caktuar, duhet të sigurohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur nuk ekziston ndonjë formë tjetër identifikimi, lejohet të thuhet "jo i aplikueshëm (N/A)".
130-170	**Personi me përgjegjësi operacionale për sigurimin e informacionit** Personi me pozicionin më të lartë, i cili ka përgjegjësinë operacionale për sigurimin e informacionit.
130	**Emri** Emri, mbiemri
140	**Funksioni**
150	**Departamenti**
160	**Numrat e telefonit** Numri i telefonit të departamentit dhe numri i telefonit personal të personit, emri i të cilit paraqitet në kolonën 130.
170	**Adresat e postës elektronike (*e-mail*)** Adresa e *e-mail*-it të departamentit dhe adresa personale e *e-mail*-it të personit, emri i të cilit paraqitet në kolonën 130.

Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet
200	**Pesha në treg (në përqindje)** Në këtë kolonë, duhet të raportohet pesha e llogaritur (ose e vlerësuar) e tregut, e shprehur në përqindje. Pesha e tregut duhet të llogaritet duke pjesëtuar vlerën e llogarive/numrin e transaksioneve (sipas funksionit) të bankës raportuese me vlerën e përgjithshme/numrin e transaksioneve në treg (ose në gjithë vendin).
210	**Numri i klientëve (në mijë)** Në këtë kolonë, duhet të përfshihet numri i përgjithshëm i klientëve për një shërbim të caktuar (p.sh. pranimin e depozitave, kredidhënien, shërbimet e pagesave, tregjet e kapitalit, tregun ndërbankar). Nëse një klient ka më shumë se një llogari ose kryen transaksione të shumëfishta, klienti duhet të numërohet vetëm një herë.
220	**Numri i llogarive (në mijë)** Në këtë kolonë, duhet të përfshihet numri i përgjithshëm i llogarive (vetëm për shërbimet e pranimit të depozitave). Numri i llogarive duhet të korrespondojë me vlerën e llogarive dhe numrin e klientëve të raportuar për të njëjtin shërbim.
230	**Vlera e llogarive (në milionë lekë)** Në këtë kolonë, duhet të përfshihet vlera totale e mbajtur në llogaritë rrjedhëse dhe të kursimit (për shërbimet e pranimit të depozitave) ose totali i tepricës së kredisë (për shërbimet e kredidhënies), siç paraqitet në bilanc dhe duhet të korrespondojnë me numrin e klientëve të raportuar për të njëjtin shërbim.
235	**Ekspozimet jashtë bilancit (në milionë lekë)** Në këtë kolonë, duhet të raportohet ekspozimi total jashtë bilancit (vetëm për shërbimet e kredidhënies), pas aplikimit të rregullimit të vlerës sipas aneksit 2, të rregullores "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" dhe duhet të korrespondojë me numrin e klientëve të raportuar për të njëjtin shërbim.

240	**Ekspozimet e ponderuara me rrezikun (në milionë lekë)** Kjo kolonë plotësohet vetëm për shërbimet e kredidhënies dhe duhet të përfshijë shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun si për vlerën e bilancit të llogarive ashtu dhe në çdo ekspozim jashtë bilancit, që korrespondon me klientët e përfshirë në kolonën e "numrit të klientëve" për këtë shërbim.
250	**Numri i transaksioneve (në mijë)** Kjo kolonë plotësohet vetëm për shërbimet e pagesave, shërbimet me *cash*-in *(ATM etj.)* dhe shërbimet e shlyerjes së titujve dhe tregon numrin mesatar të transaksioneve ditore përgjatë një viti (ose përgjatë një periudhe tjetër nëse mesataret vjetore nuk janë të disponueshme). Për shërbimet me *cash*-in, kjo kolonë duhet të përfshijë numrin mesatar të tërheqjeve nga ATM-të dhe tërheqjeve në sportel, ndërsa për shërbimet e shlyerjes së titujve, kjo kolonë duhet të përfshijë numrin e transaksioneve të transferimit të titujve të shlyera për llogari të klientëve.
260	**Vlera e transaksioneve (në milionë lekë)** Kjo kolonë plotësohet vetëm për shërbimet e pagesave, shërbimet me *cash*-in dhe shërbimet e shlyerjes së titujve dhe tregon vlerën mesatare të transaksioneve ditore përgjatë një viti (ose përgjatë një periudhe tjetër nëse mesataret vjetore nuk janë të disponueshme). Për shërbimet me *cash*-in dhe shërbimet e shlyerjes së titujve, vlerat duhet të korrespondojnë me llojin e transaksioneve të përfshira në "numrin e transaksioneve".
270	**Numri i ATM-ve** Kjo kolonë plotësohet vetëm për shërbimet me *cash*-in dhe duhet të tregojë numrin e terminaleve të ATM-ve (të zotëruara nga banka) në Shqipëri, pavarësisht vendndodhjes së tyre, për shembull nëse janë brenda degëve të bankës apo diku tjetër.
280	**Aktive nën administrim/kujdestari (në milionë lekë)** Kjo kolonë përfshin vlerën totale të aktiveve nën administrim (për shërbimet e administrimit të aktiveve) ose aktivet në kujdestari (shërbimet e marrjes në kujdestari) që korrespondojnë me "numrin e klientëve" të raportuar për shërbimin përkatës**.**
290	**Të tjera** Kjo kolonë përfshin çdo informacion të përshtatshëm ose të rëndësishëm për shërbimet individuale që nuk janë raportuar diku tjetër, së bashku me komentet përkatëse.

Për çdo funksion të identifikuar, bankat duhet të ofrojnë një sërë të dhënash sasiore për të mbështetur vlerësimin nëse funksioni është ose jo kritik. Lloji i të dhënave të kërkuara ndryshon në varësi të funksionit që po shqyrtohet. Formulari përmban kolona për lloje të ndryshme të të dhënave të aplikueshme sipas funksioneve – për këtë arsye, jo të gjitha kolonat do të duhet të plotësohen për secilin funksion. Nëse një e dhënë nuk është e aplikueshme për një funksion, kjo qelizë duhet të lihet bosh.

Udhëzime për plotësimin e kolonave me të dhëna sasiore:

Për çdo funksion të identifikuar, bankat duhet të sigurojnë (kryesisht) informacion cilësor në lidhje me zëvendësueshmërinë e një funksioni të caktuar, nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut. Kur ky informacion nuk është i disponueshëm për një funksion të caktuar, fusha përkatëse duhet të lihet bosh dhe të jepet një koment për këtë çështje në kolonën 340.

Udhëzime për plotësimin e kolonave që lidhen me analizën e zëvendësueshmërisë:

Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet
300	**Përqendrimi i tregut** Përqendrimi i tregut matet me numrin e konkurrentëve që aktualisht kryejnë funksione të ngjashme ekonomike dhe/ose ofrojnë shërbime të ngjashme me kushte të njëjta, që potencialisht mund të marrin (pjesërisht ose plotësisht) klientët dhe/ose veprimtaritë e bankës raportuese, brenda një intervali kohor të arsyeshëm. Informacioni duhet të raportohet duke përzgjedhur një nga alternativat e mëposhtme: L: <5 ML: 5-10 MU: 10-20 U: ≥ 20
310	**Koha e zëvendësimit** Koha e zëvendësimit duhet të llogaritet si koha e nevojshme për përthithjen nga tregu të funksionit ekonomik të ofruar nga banka raportuese, në një situatë krize. Koha duhet të përfshijë si kohën që u nevojitet konkurrentëve për të përmbushur hapat ligjorë dhe teknikë për të marrë/ofruar funksionin, ashtu edhe kohën që nevojitet për përdoruesit e shërbimit për t'u zhvendosur në një ofrues tjetër shërbimi. Informacioni duhet të raportohet duke përzgjedhur një nga alternativat e mëposhtme: **Depozitat, kredidhënia, tregjet e kapitalit** L: > 6 muaj **Pagesat, shërbime me *cash*-in, shlyerje, shërbimi i marrjes në kujdestari** L: > 1 javë **Tregu ndërbankar** L: > 1 muaj

Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet		
	ML: 1-6 muaj	ML: 2 ditë – 1 javë	ML: 1 javë – 1 muaj
	MU: 1 javë deri 1 muaj	MU: 1 -2 ditë	MU: 1 ditë – 1 javë
	U: < 1 javë	U: < 1 ditë	U: < 1 ditë
320	**Pengesat ligjore të zëvendësimit** Këtu vlerësohet rëndësia e pengesave ligjore që hasin konkurrentët për të ofruar shërbimin, p.sh. licenca, kapitali minimal i kërkuar etj. Informacioni duhet të raportohet duke përzgjedhur një nga alternativat e mëposhtme: **L: pengesa kritike (të vështira për t'u kapërcyer)** **ML: pengesa thelbësore (por të kapërcyeshme)** **MU: ka disa pengesa** **U: nuk ka pengesa të mëdha**		
330	**Kërkesat operacionale të zëvendësimit (hyrja ose zgjerimi në treg)** Këtu vlerësohet rëndësia e kërkesave operacionale, teknike dhe infrastrukturore për konkurrentët që do të ofrojnë shërbimin. Këtu përfshihen kërkesat për të investuar në infrastrukturë (të re ose shtesë) ose ndryshime organizative të konkurrentëve. Kjo kolonë duhet të përfshijë edhe një vlerësim të aftësisë së tregut për të përthithur (absorbuar) një veprimtari të caktuar, në terma, p.sh. të kërkesave për kapital. Informacioni duhet të raportohet duke përzgjedhur një nga alternativat e mëposhtme: **L: kërkesa kritike (të vështira për t'u përmbushur)** **ML: kërkesa thelbësore (por të realizueshme/që mund të përmbushen)** **MU: ka disa kërkesa** **U: nuk ka kërkesa të mëdha**		
340	**Komente** Në këtë kolonë, banka duhet të përfshijë komente në lidhje me pengesat specifike ligjore dhe/ose operacionale, si dhe arsyet për një kohë më të gjatë të zëvendësimit, në rastet kur ML ose L janë zgjedhur në secilën nga listat e alternativave për elementet e mësipërme.		

Udhëzime për plotësimin e kolonave mbi vlerësimin e kritikalitetit të një funksioni:

Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet
400	**Ndikimi (impakti)** Në këtë kolonë, duhet të paraqitet një vlerësim i përgjithshëm mbi ndikimin e pritshëm të ndërprerjes së secilit funksion, duke marrë parasysh treguesit e ndryshëm të vlerësuar më parë (p.sh. madhësia, pjesa e tregut). Përfundimi mbi vlerësimin e përgjithshëm të ndikimit duhet të shprehet në mënyrë cilësore dhe duhet të raportohet duke përzgjedhur një nga alternativat e mëposhtme. **L: ndërprerja ka një ndikim të madh në tregun kombëtar** **ML: ndikimi është i rëndësishëm** **MU: ndikimi është material, por i kufizuar** **U: ndikimi është i ulët** Për aktivitetet e kredidhënies, vlerësimi i ndikimit duhet të paraqesë pikëpamjen e bankës mbi ndikimin e ndërprerjes së ofrimit të kredive për individët, korporatat dhe qeverinë, mbi këto grupe interesi dhe mbi ekonominë e vendit në tërësi.
410	**Zëvendësueshmëria** Në këtë kolonë, duhet të paraqitet një vlerësim i përgjithshëm i shkallës së pritur të zëvendësueshmërisë për secilin funksion, duke marrë parasysh dimensionet e ndryshme të vlerësuara më parë (pjesa e tregut, përqendrimi i tregut, koha e zëvendësimit, pengesat ligjore dhe kërkesat operacionale për hyrjen ose zgjerimin në treg). Përfundimi mbi vlerësimin e përgjithshëm të zëvendësueshmërisë duhet të shprehet në mënyrë cilësore dhe duhet të raportohet duke përzgjedhur një nga alternativat e mëposhtme. **L: funksioni nuk mund të zëvendësohet lehtë ose shpejt** **ML: funksioni zëvendësohet me vështirësi** **MU: funksioni mund të zëvendësohet me vështirësi të pakta** **U: funksioni mund të ofrohet lehtësisht nga një bankë tjetër në kushte të krahasueshme dhe brenda një afati kohor të arsyeshëm**
420	**Funksion kritik** Në këtë kolonë, tregoni nëse funksioni është kritik duke përzgjedhur "Po" ose "Jo" nga lista e alternativave. Sa më i madh të jetë ndikimi, aq më shumë gjasa ka, që funksioni të jetë kritik. Në mënyrë të ngjashme, sa më e vështirë është të gjendet një ofrues tjetër i krahasueshëm, aq më shumë pritet që funksioni të jetë kritik.
430	**Komente** Në këtë kolonë, banka mund të paraqesë komente shtesë që ndikojnë në vlerësimin e saj, nëse funksioni është kritik ose jo. Këto komente janë të rëndësishme, veçanërisht nëse banka e konsideron një funksion si jo kritik, pavarësisht se ky i fundit ka një peshë të lartë të tregut ose, e kundërta, nëse e konsideron një funksion si kritik, pavarësisht se e ka vlerësuar me një

	ndikim relativisht të ulët.

Shënime shpjeguese për plotësimin e formularëve të aneksit nr. 4, për raportimin e informacionit sasior të planit të rimëkëmbjes

Kodi i ngjyrave
Qelizat në ngjyrë të gjelbër duhet të plotësohen nga banka.
Qelizat në ngjyrë të verdhë plotësohen automatikisht mbi bazën e informacionit të vendosur në qelizat e tjera. Megjithatë, ato duhen rishikuar me kujdes dhe ndryshuar kur është e përshtatshme.
Qelizat në ngjyrë gri nuk duhet të ndryshohen.
Aty ku jepen shembuj të plotësimit, ju lutemi të fshini shembujt kur të plotësoni me të dhënat tuaja.

Formulari 1: Kuadri i treguesve të planit të rimëkëmbjes
Në këtë formular paraqisni një pasqyrë të plotë të të gjithë treguesve dhe kufijve, të cilët aktivizojnë planin e rimëkëmbjes. Për listën e treguesve minimalë, formulari është i plotësuar. Për tregues të cilët nuk përdoren, nuk ka nevojë të jepen vlera. Për tregues shtesë specifikë të bankës, ju lutem të vendoset informacioni në grupimin e dytë "tregues të tjerë".

Formulari 2a: Masat e rimëkëmbjes: secila më vete *(stand alone*) në datën e sotme
Në këtë formular paraqisni një pasqyrë të plotë të të gjitha masave të rimëkëmbjes që do të ndërmerrni potencialisht, kur të aktivizohet plani i rimëkëmbjes. Secila masë e mundshme e rimëkëmbjes duhet të kategorizohet, vlerësohet për zbatueshmërinë dhe të përshkruhet nga ana sasiore për treguesit më të rëndësishëm, të detyrueshëm, të marrë secili më vete (*on a stand-alone basis*) (d.m.th. nëse përdoret vetëm kjo masë e rimëkëmbjes dhe asnjë tjetër). Ju lutem vlerësoni ndikimin në nivelin e kapitalit, situatën e likuiditetit etj., në kushtet e skenarit bazë (mungesë krize). Me ndihmën e tabelave të tjera, ju do të jeni në gjendje të përshtasni vlerësimet e lartpërmendura për skenarë specifikë krizash. Për masa të pazbatueshme, nuk nevojitet të jepet një përshkrim sasior (por, ju lutem përfshijini ato në listë, në mënyrë që të jetë e qartë se ato janë marrë në konsideratë).

Formulari 2b: Masat e rimëkëmbjes: aftësia e agreguar e rimëkëmbjes (në datën e sotme)
Ky formular është një kopje e Formularit 2a, megjithatë, kur ta plotësoni atë, supozoni se të gjitha masat e rimëkëmbjes janë përdorur në të njëjtën kohë. Pra, Formulari 2b duhet të përmbajë vetëm masën më efektive, në kushtet kur dy ose më shumë masa përjashtojnë njëra - tjetrën.

Formulari 3: Skenari A, B, C... deri në fund
Për të kontrolluar efektivitetin e sistemit të treguesve të rimëkëmbjes dhe aftësinë për t'u rimëkëmbur (masat e rimëkëmbjes), në planin e rimëkëmbjes duhen përfshirë disa skenarë hipotetikë krizash. Duke marrë si shembull formatin e paraqitur në Formularin 3, mund të shtoni skedarë *(worksheets)* të tjerë për secilin nga skenarët e ndërtuar. Kur të kopjoni, lutem fillojeni emrin e çdo tabele me "F3" (d.m.th. "F3 - Skenari A", "F3 - Skenari B",...) Për të matur ndikimin e skenarit, supozoni se nuk është përdorur asnjë masë rimëkëmbjeje. Ju lutem jepini të gjitha efektet në mënyrë kumulative.

Formulari 4: Masat e rimëkëmbjes nën skenarin A, B, C ...deri në fund
Ashtu si për Formularin 3, kopjoni dhe plotësoni nga një shembull të Formularit 4 për çdo skenar. Formulari 4 është i njëjtë si strukturë me Formularin 2. Diferenca qëndron se ndërkohë që Formulari 2 teston ndikimin e përgjithshëm të masave të rimëkëmbjes në treguesit e rimëkëmbjes (d.m.th. pavarësisht nga skenari), për Formularin 4 duhet të ofrohen shifrat për ndikimin e masave në skenarin specifik (d.m.th. disa nga masat mund të mos jenë më të zbatueshme, efektet e masave mund të ndryshojnë në një skenar specifik, etj.). Formulari 4 është i plotësuar që më parë nga Formulari 2, megjithatë vlerësoni për çdo qelizë individuale nëse vlerat janë ende të vlefshme, sipas supozimeve të skenarit dhe nëse nevojitet, shkruani mbi ato (për shembull *haircuts* më të larta mbi shitjet e aktiveve në një krizë sistemike).

Të gjithë formularët
1. Nuk duhet të shtoni rreshta dhe kolona në tabela, nëse nuk është lejuar me një koment.
2. Qelizat në ngjyrë të verdhë i marrin vlerat nga informacioni i vendosur në tabelat e mëparshme (p.sh. F2b dhe F4 i referohen F2a-së). Në raste të devijimeve të vlerave (p.sh. një masë ka efekte më të ulëta në një skenar specifik), ju duhet të shkruani mbi formulat.
3. Qelizat në ngjyrë gri nuk duhet të ndryshohen. Nuk duhet të shkruani mbi formulat. Këto qeliza qëllimisht nuk janë të bllokuara *(lock),* për të krijuar sa më tepër fleksibilitet.
4. Ju lutem përzgjidhni njësinë matëse "Përqindje" dhe vendosini vlerat pa i shoqëruar me ndonjë njësi (p.sh. një tregues likuiditeti prej 120 për qind do të shkruhej në F1 si "120", jo "120%", "1,2" etj).

Formularët F2a, F2b, F4
Formularët janë hartuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, me qëllim që t'u ofrojnë të gjitha bankave hapësirën e mjaftueshme për të përshkruar masat e tyre. Bankat mund të mos i plotësojnë të gjithë rreshtat.

Kodi i ngjyrave
Qelizat në ngjyrë të gjelbër duhet të plotësohen nga banka.
Qelizat në ngjyrë të verdhë plotësohen automatikisht mbi bazën e informacionit të vendosur në qelizat e tjera. Megjithatë, ato duhen rishikuar me kujdes dhe ndryshuar kur është e përshtatshme.
Qelizat në ngjyrë gri nuk duhet të ndryshohen.